

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj, si kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët Kymete Kicaj e Gani Kastrati anëtarë, me procesmbajtësen Birsën Kume – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit, B. H. nga fshati ..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 100/2016 të datës 30.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit, mbrojtësit të tij av. V. O. nga Prizreni, përfaqësuesi i të dëmtuarës Hidroregjioni Jugor në Prizren Kadri Zogaj, më datë 22.03.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. H., me nofkën “B.”, nga i ati M. dhe e ëma M., e vajzërisë I., i lindur me ... në fshatin ..., Komuna e Dragashit, ku edhe tani jeton, me nr. personal ..., i martuar – baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse prej muajit tetor të vitit 2015 e deri në muajin shkurt 2016, në Dragash, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës dhe pozitës së tij, në atë mënyrë që duke ushtruar detyrën e arkatarit në njësinë punuese të “Hidroregjinoit Jugor” në Dragash, përvetëson dhe merr nga arka kohë pas kohe shuma të caktuara të parash, ashtu që përvetëson shumën e të hollave prej gjithsej 3.033,98 €

- Këso dore ka kryer veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 43, par. 1 nënpar. 1.2, 45, 73 dhe neni 425 par.1 të KPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Gjykata në pajtim me nenin 62 par. 1 dhe 2 pika 2.3 lidhur me nenin 66 të KP-së të akuzuarit B. H. i shqipton:

DËNIMIN PLOTËSUES

- Ndalimin e ushtrimit të profesionit të arkatarit në kohëzgjatje prej 2 viteve.

- Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Njësia Punuese “ Hidroregjioni Jugor”, në Dragash t`ia kompenzojë dëmin në lartësi prej 3.033,98 euro.

- Obligohet i akuzuari që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 150 Euro, të cilat do ti paguaj në afat prej 15 dite, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.100/2016 të datës 30.06.2016 kundër të akuzuarit B. H. nga fshati ..., Komuna e Dragashit, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPK-së. Prokurori i shtetit, në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ngritur kundër të akuzuarit të lartëpërmendur pasi që nga të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale dhe provave të cilat janë administruar, në mënyrë të plotë është provuar dhe vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës se i akuzuari me veprimet e tij ka kryer veprën penale e cila i bie në barrë. Në vazhdim poashtu ka shtuar se nga provat materiale të cilat janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe nga një pjesë e mbrojtjes së të akuzuarit tregojnë në mënyrë të plotë mbi vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale, ndërsa pjesës tjetër të mbrojtjes e cila është orientuar në mohimin e veprës penale nuk duhet të merret për baze në rastin e vlerësimit nga ana e gjykatës. Po kështu, Prokurori i shtetit, gjatë fjalës së tij përfundimtare ka bërë precizimin e aktakuzës, lidhur me dëmin e shkaktuar, ku në vend të shumës së mëhershme në aktakuzë, tani duhet të qëndroj shuma prej 3.033,98 euro, dhe se i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale e cila i bie në barrë dhe të njëjtit të i shqiptohet dënimi i paraparë konform dispozitave ligjore, si dhe poashtu ndaj tij të shqiptohet edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit të arkatarit në institucionet publike.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se e mbështet fjalën përfundimtare të Prokurorit të shtetit dhe njëherit ka parashtruar kërkesën pasurore juridike në vlerën e lartëpërmendur.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. V. O., ka theksuar se pas administrimit të provave, me asnjë provë të vetme nuk është mundur të vërtetohet përgjegjësia penale e të akuzuarit për përvetësimin në detyrë në shumën në të cilën është përshkruar në dispozitiv të cilat janë cekur në dokumentet zyrtare të hidroregjionit dhe atë të raportit final të auditimit, mendimi i dhënë nga komisioni i përbërë për verifikim i cili nuk kanë përputhshmëri, dhe se në të njëjtën kohë nuk janë dorëzuar edhe dokumentet mbështetëse financiare që kanë shfrytëzuar këto organe për përfundimet të cilat i kanë nxjerrë. Në vazhdim ka theksuar se edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve të dy zyrtarëve Y. S. dhe A. Z. të cilët kanë përshkruar në detaje edhe procedurën e arkëtimit të mjeteve nga ana e arkatarit është përmendur pamëdyshje që çdo përfundim është plotësuar edhe ditari i arkës i nënshkruar nga arkatari dhe menagjeri i njësisë i cili dokument asnjëherë nuk është dorëzuar gjykatës për ti shikuar vlefshmërinë dhe bazueshmërinë e mendimeve dhe përfundimeve të nxjerra nga organet gjegjëse të të dëmtuarës. Po ashtu ka shtuar se është administruar i ashtuquajtur i hyrje-dalje nga arka që në vetëpërmbarjen e saj gjykata nuk duhet të ia falë besimin e saj si një dokument zyrtar pasi që i njëjti

nuk ka as nënshkrimin e personit përgjegjës e as vulën e institucionit përkatës, duke pasur parasysh se edhe në procedurën e hetimore nuk ka një ekspertizë financiare që të mbështet pretendimet e prokurorisë për përvetësim në detyrë nga i akuzuari, bën që i njëjti me asnjë provë të vetme të mos mund të vërtetohet se është përgjegjës për atë të cilën akuzohet. Në vazhdim ka shtuar se ekspertiza e cila është administruar në rihapje të kësaj çështje penale gjykata nuk duhet të fali besimin e plotë pasi që e njëjta është e mangët për nga përmabjtja, nuk është e mbështetur në prova financiare që kanë shërbyr për përpilimin e saj, ndërsa shënimet në këtë ekspertizë janë vetëm bartje formale e shënimeve të dhënë nga komisioni mbikëqyrës financiar i të dëmtuarës. Në fund ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara të akuzuarin të shpall të pafajshëm në mungesë të provave se i njëjti ka kryer veprime që do të ishin elemente qenëse të veprës për të cilën akuzohet.

I akuzuari B. H. gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor i ka nxjerr të gjitha provat e domosdoshme dhe pas vlerësimit të secilës prove veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi, ka vërtetur këtë gjendje faktike.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari prej muajit tetor të vitit 2015 e deri në muajin shkurt 2016, në Dragash, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës dhe pozitës së tij, në atë mënyrë që duke ushtruar detyrën e arkatarit në njësinë punuese të “Hidroregjionit Jugor” në Dragash, përvetëson dhe merr nga arka kohë pas kohe shuma të caktuara të parash, ashtu që përvetëson shumën e të hollave prej gjithsej 3.033,98 €.

Per vertetimin e gjendjes faktike gjykata ka bërë leximin në draft raportin e auditimit të brendshëm mbi menaxhimin e arkës në Njësinë Punuese në Dragash e kryer nga zyra e auditimit të brendshëm të Hidroregjionit Jugor në Prizren me nr. 188 me datë 25.02.2016; leximin në raportin e komisionit për regjistrimin dhe verifikimin e gjendjes në arkën e Njësisë Punuese në Dragash nga K.R.U Hidroregjioni Jugor në Prizren nr.243 të datës 07.03.2016; leximin në regjistrin me të dhënat të hyrjeve daljeve të arkës për periudhat gjatë muajit 02/2016 dhe 01/2016; leximi në deklaratën e të akuzuarit B. H. të dhënë në Hidroregjionin Jugor në Prizren me dorëshkrim; leximin në aktvendimin për inicimin e procedurës disiplinore nga K.R.U Hidroregjioni Jugor në Prizren me nr.195 të datës 26.04.2016 kundër B. H.; leximin në vendimin mbi largimin-suspendimin e përkohshëm nga puna të akuzuarit B. H. të lëshuar nga K.R.U Hidroregjioni Jugor nr. 194 me datë 26.04.2016; dëgjimin e dëshmitarit Y. S., dëgjimin e dëshmitarit A. Z.; leximin e raportit final mbi auditimin e arkës të Njësisë Punuese në Dragash me nr.189 të datës 25.02.2016; leximin e njoftimit nga ushtruesit e detyrës të Njësisë Punuese në Dragash me nr. 190 të datës 25.02.2016; leximi në vendimin për emërimin e komisionit për regjistrimin dhe verifikimin e gjendjes në arkën e njësisë punuese në Dragash nr. i prot. 196 të dt. 26.02.2016; leximin e ekspertizës financiare të kryer nga eksperti I. K. i dt. 17.03.2017 si dhe dëgjimin e tij në shqyrtim gjyqësor me dt. 21.03.2017.

Dëshmitarit Y. S. gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se punon si auditor i brendshëm pranë “Hidroregjionit Jugor”, dhe me kërkesën e ushtruesit të menaxherit të Njësisë në Dragash z. Ç. T., lidhur me pretendimet dhe dyshimet në arkë, është bërë auditimin në këtë Njësi në Dragash, lidhur me kontrollimin dhe barazimin e arkës për peridhën nga data 01.10.2015 deri më 31.01.2016. Në vazhdim ka theksuar se në bazë të detyrave të punës arkatari obligohet që të mbajë ditarin e arkës në të cilën përfshihen të gjitha të hyrat dhe të dalat, në të cilën hynë të gjitha inkasimet, shpenzimet dhe deponimet në bankë, dhe sipas të gjeturave të auditimit është konstatuar se gjatë kësaj periudhë

një pjesë e të hyrave apo inkasimeve të realizuara nuk kanë qenë të regjistruara në ditarin e arkës dhe si të tilla nuk janë deponuar në bankë, duke theksuar në këtë rast auditimi fokusun në këtë rast e ka pasur në rregullsin e këtij procesi dhe nuk e ka pasur kuptimin e barazimit të saktë gjendjes, dhe për këtë është rekomanduar menaxhmentit të kompanisë si dhe menaxherit të njësisë në Dragash, fillimisht të formohet një komision profesional dhe të bëhet regjistrimi dhe prezantimi i saktë i gjendjes apo mungesës së konstatuar dhe të meren masa ndaj punëtorit në pajtim me kushtet dhe ligjet në fuqi. Në vazhdim ka shtuar se në këtë kompani ekziston rregullore interne e cila është e bazuar në ligjet në fuqi, ku përshkruhen procedurat që duhet ndjekur arkatari në detyrën e tij të punës në të cilën përcaktohet që arkatari në ditarin e arkës bën regjistrimin e të gjitha inkasimeve ditore në bazë të urdhëresave që i lëshon konsumatorëve. Në kompani ka nevojë për realizimin e disa shpenzimeve ditore, pagesat e furnitorëve arsyetohen me fatura gjegjëse, fatura të cilën arkatari e regjistron në ditarin e arkës, në fund të ditës bëhet mbyllja e ditarit, saldoja që mbetet në fund të ditës ka për obligim që të deponojë në bankën komerciale në Dragash, ditarët mbahen në bazë të numrit rendor, të nesërmen fillon numri tjetër dhe kështu vazhdon në mënyrë kronologjike. Më tutje dëshmitari ka shtuar se kompania e “Hidroregjionit”, ka sistem të pagesave elektronike, i cili sistem funksionon mbi bazën e regjionit, mirëpo në Njësinë e Dragashit, janë të ndara përgjegjësist ku shkarkimi bëhet në sistemin e faturimit, mirëpo fizikisht pagesat bëhen me dorë sepse pala si palë vjen në arkë dhe e bën pagesën, ndërsa shkarkimi i asaj bëhet në sistemin e faturimit, mirëpo kjo në Regjion e Prizrenit. Në vazhdim dëshmitari ka shpjeguar se me rastin e auditimit të bërë në kompanin e Hidroregjioni, në rastin konkret është rishikuar dokumentacioni i arkës që është marrë nga shërbimi i kontabilitetit në regjion e Prizrenit, dhe është bërë krahasimi i këtyre të dhënave financiare nga sistemi elektronik i faturimit në Prizren, si dhe nga raportet financiare të përgatitura dhe të raportuara nga ushtruesi i detyrës menaxherit të Njësisë së Dragashit dhe nga të gjitha këto është konstatuar një shumë e konsideruar i mjeteve të inkasuara nga konsumatorët nuk janë prezentuara si hyrje në ditar të arkës, që nënkupton se të njëjtat nuk janë deponuar, dhe shuma e përafërt e për këtë periudhë ka qenë 2500 euro. Në vazhdim dëshmitari ka potencuar se në degën e Hidroregjionit në Dragash është vetëm një arkatar, dhe kryesisht ai ka qasje në regjistrimin e ditarit të pagesave e cila është e programuar në kompjuter, ndërsa në mungesë të tij mund të bëjë edhe zëvendësuesi tjetër ose menaxheri, dhe pas regjistrimit të dhënave në kompjuter në programin exell, e njëjta printohet dhe në njërën anë nënshkruhet nga përgjegjësi i arkës – arkatari dhe menaxheri i njësisë, dhe në bazë të këtyre nënshkrimeve është nënkuptuar se inkasomi dhe aprovimi është bërë nga dy persona arkatari B. H. dhe ushtruesi i detyrës – menaxheri Ç. T. Në vazhdim dëshmitari ka theksuar se gjatë auditimi prezent ka qenë menaxheri i njësisë, ndërsa i akuzuari edhe pse është kërkuar takimi me të, i njëjti nuk është paraqitur, duke potencuar se ky auditim është bërë si auditim i jashtëzakonshëm dhe si i tillë është auditim i plotë edhe pa prezencën e të akuzuarit, duke theksuar se llojet e auditimeve janë të pajtueshmërisë, financiare dhe auditim i performancës dhe në rastin konkret, ky auditim ka qenë i performancës.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitarit Y. S., përndryshe auditor i brendshëm pranë “Hidroregjionit Jugor”, të cilës deklaratë gjykata ia fali besimin, është vërtetuar se në bazë të kërkesës së menagjmentit të kompanisë është bërë auditimi i arkës në Njësinë e Dragashit lidhur me kontrollimin dhe barazimin e gjendjes për periudhën 01.10.2015 deri më 31.01.2016. Në bazë të detyrave të punës, rregulloreve interne në këtë kompani ku përshkruhen të gjitha procedurat, arkatari është i obliguar që të e mbajë ditarin e arkës në të cilën regjistrohen të gjitha të hyrjet dhe daljet, ku përfshihen inkasimin ditor në bazë të urdhëresave që lëshohen për konsumatër, shpenzimet si dhe deponimet në bankë, dhe në këtë rast, sipas auditim është vërtetuar se një pjesë e inkasimeve të realizuar nga konsumatërot nuk janë regjistruar në ditarin e arkës si hyrje, dhe si të tilla edhe nuk janë deponuar në bankë, dhe se shuma e përafërt e diferencës për këtë periudhë ka qenë diku 2500 euro, dhe për konstatimin e saktë të diferencës në arkën e kësaj Njësie, menagjmentit është rekomanduar që të formohet një komisioni profesional, dhe të bëhet regjistrimi i saktë i gjendjes së

konstatuar dhe njëherit ndaj punëtorit përgjegjës – arkatarit të meren masat në pajtim me ligjin. Po ashtu është vërtetuar se në kompanin e Hidroregjionit Jugor”, ekziston sistemi i pagesave elektronike, por në Njësinë e Dragashit, përgjegjësist janë të ndara ku shkarkimet bëhen në sistemin e faturimit, ndërsa pagesat nga konsumatërve bëhen në mënyrë me dorë (lëshimin e dëftesë pagesës), ndërsa shkarkimi i saj bëhet me sistemin e faturimit, në Regjionin e Prizrenit. Po ashtu është vërtetuar se gjatë auditimit që është bërë në këtë Njësi, prezent ka qenë menaxheri i kësaj Njësie Ç. T., ndërsa i akuzuari ka munguar edhe pse i njëjti ka qenë i njoftuar.

Nga dëgjimi i dëshmitarit A. Z., i cila ka deklaruar se punon si shef i kontabilitetit në “Hidroregjionit Jugor” në Prizren, dhe si anëtarë i komisionit prej tre anëtarësh ka bërë verifikimin e të dhënave në kuadër të financave në Njësinë e Dragashit, dhe së bashku me njërin prej anëtarëve të komisionit ka qenë në Dragash, ku fillimisht kanë bërë verifikimin e dokumentacionit dhe harmonizimin e tij me sistemin e kontabilitetit, i cili është i përbashkët dhe unik në kuadër të kompanisë së tyre, dhe pas përfundimit të punës së tyre kanë ardhur në përfundim se shuma financiare për periudhën e caktuar të verifikimit, ka pasur një disproporcion dhe mosharmonizim i të dhënave financiare në shërbimin e kontabilitetit në bazën e konsumatorëve me arkën e xhirollogarisë. Më tej ka shtuar se dokumentet të cilat janë përdorur nga ana e komisionit për verifikim, kanë qenë dëftesat e konsumatorëve, pra të pagesave të cilat janë bërë, të cilat kanë qenë të futura në sistemin data bazë, parat të cilat i kanë paguar konsumatorët për periudhën e caktuar, kanë bërë verifikimin se a janë shkarkuar nga gjendja e konsumatorit si pagesa, por se mjetet të cilat janë grumbulluara nga inkasimi dhe dëftesave që i janë regjistruar nuk janë përputhur me shumën e dorëzuara në arkë dhe xhirollogari, duke potencuar se ka pasur mungesë të hollave “kesh”, dhe në llogari bankare të kompanisë. Në vazhdim dëshmitari ka theksuar se sipas rregullores së punës, arkatarit ka për detyrë që këto mjete në çfardo forme qofshin ato a janë në arkë apo pagesa, që ato mjete t’i dorëzojë në llogarin bankare të kompanisë, me përjashtim që këto mjete mund të dorëzohen edhe në ditën vijuese në këtë xhirollogari. Më tutje ka shtuar se arkatarit ka autorizime që të bëjë edhe pagesat e shpenzimeve, me autorizimin e personit përgjegjës, ndërsa gjatë kontrollimit të hyrjeve dhe daljeve të arkës, fokusi i tyre ka qenë në hyrjet të cilat janë bërë në arkë dhe a ka pasur deponim nga ana e arkatarit në xhirollogarinë apo arsytimin me faturat e shpenzimeve, dhe gjatë kontrollimit është vërtetuar se ka pasur edhe fatura të shpenzimeve të cilat janë prezentuara, dhe prej këtyre faturave të shpenzimeve është shkaktuar shuma e cila është inkasuar në arkë, por se në pjesën e mbetur nuk kanë hasur në barazim të plotë në ditarin e arkës me dëftesa, dhe përveç kësaj kanë bërë edhe verifikimin e të gjitha llogarive bankare të kompanisë, ku janë eliminuar të gjitha gabimet teknike të ndodhura dhe pas eliminimit të tyre kanë konstatuar gjendjen si në raport. Më tutje dëshmitari ka theksuar se pjesë e raportit të përpiluar kanë qenë edhe dokumentet zyrtare të kompanisë në Njësinë e Dragashit, të cilat janë gjeneruar nga softveri (programi) i përbashkët të cilën e ka kompania, në të cilën program kanë qasje personat të cilët kompania ka konsideruar se duhet të kenë, dhe njëri prej këtyre personave që ka pasur qasje është edhe arkatarit – akuzuari. Në këtë softver (program) të gjithë futen me kodin e tyre, ku gjurmët si dhe shënimet mund të verifikohen në çdo moment se kush, koha dhe se kur ka futur të dhëna, si dhe sa orë ka punuar në këtë softver (program). Në vazhdim ka theksuar se në ditën në të cilën është caktuar nga menaxhmenti për të bërë verifikimin, kanë njoftuar menaxhmentin e Njësies në Dragash që të jenë prezent edhe personat përgjegjës, por në ditën e caktuar kur kanë arritur aty janë takuar me menaxherin dhe personin i cili i fut të dhënat në bazën e konsumatorëve, ndërsa arsytimi i menaxherit ka qenë se arkatarit – akuzari do të jetë prezent, por se i njëjti nuk është prezentuar dhe menaxheri i kësaj Njësie ka sqaruar se arkatarit – akuzuari nuk po e hap telefoni, dhe me këtë rast komisioni ka vazhduar me punë dhe verifikimin e dokumenteve të cilat janë prezentuar, dhe nga kopjet fizike të ditarëve, për të cilët arkatarët janë të obliguar ligjërisht që përpos mbajtjes së ditarit në formë elektronike, janë të obliguar të kenë edhe kopje fizike, e cila një kopje qëndron në gjendjen e Njësies, dhe një kopje fizikisht dorëzohet në qendër në Prizren, dhe të gjitha kopjet fizike kanë

qenë të nënshkruara nga arkatari dhe personi përgjegjës i njësisë - menaxherit. Po ashtu ka shtuar se përpos shënimeve që barten në ditarin e arkës, obligimi i arkatarit dhe i personit përgjegjës që ti mbështet me dokumente plotësuese, të cilat i bashkangjitet ditarit të arkës dhe në këtë rast së bashku me kopjen fizike, gjatë punës së tyre të kontrollit kanë pasur të gjitha dokumentacionin mbështetës të arkës, të cilat dokumente i ka prezentuar atyre menaxheri i njësisë dhe përmes këtyre dokumenteve kanë bërë harmonizimin edhe me kopjen të cilën a kanë poseduar në Prizren.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitarit A. Z., përndryshe shef i kontabilitet pranë “Hidroregjionit Jugor”, dhe anëtarë i komisionit për verifikimin e të dhënave financiare pranë Njësisë në Dragash, të cilës deklarat gjykata ia fali besimin, ku vërtetohet se komisioni i përbërë prej tre anëtarëve pas verifikimit të dokumentacionit në Njësinë e Dragashit dhe harmonizimin e saj me sistemin e kontabilitetit, i cili sistem është unik për tërë kompaninë, është vërtetuar se për periudhën kritike ka pasur një mos harmonizim i të dhënave financiare në arkën e kësaj Njësie. Në të vërtetë, ky komision pas verifikimit të dokumenteve – pagesave të cilët janë paguar nga ana e konsumatorëve, të cilat pagesa kanë qenë të regjistruara në sistemin e data bazës, ka rezultuar se gjendja e konsumatorëve janë shkarkuar si pagesa, mirëpo mjetet e grumbulluara nga inkasimi dhe dëftesave që janë regjistruara nuk janë përputhur me gjendjen me shumën e të hollave të dotrëzuara në arkë dhe në xhirrollogarinë e kompanisë, pra ka pasur mungesë të hollave të gatshme, ndërsa sipas rregullores së arkatari në këtë Njësi ka për detyrë që këto mjete që gjenden në arkë, atë ditë duhet të dorëzohen në llogari bankare të kompanisë, me përjashtim të rasteve munden edhe ditën tjetër. Po ashtu është vërtetuar se arkatari në këtë Njësi, me autorizimin e personit përgjegjës ka pasur autorizime që të bëjë edhe pagesat e shpenzimeve, mirëpo gjatë kontrollimit të hyrave të cilat janë bërë në arkë, është vërtetuar se gjatë kësaj periudhë ka pasur fatura të shpenzimeve, dhe prej tyre është shkarkuar shuma e cila është inkasuar në arkë, mirëpo pjesa tjetër e mbetur nuk është barazuar me ditarin e arkës dhe dëftesave, si pas eliminimit të gjitha gabimeve dhe kontrollimit të gjitha llogarive bankare është vërtetuar gjendja si në raportin e dorëzuar nga komisioni. Po ashtu është vërtetuar se nga raporti i përpiluar nga ana e komisionit ka qenë edhe dokumentet e Njësisë në Dragash, të cilët janë gjeneruar nga softveri (programi) i përbashkët në këtë kompani, në të cilën ka pasur qasje edhe i akuzuari, ku të gjithë futen me kodin e tyre, dhe nga ky program mund të verifikohet në çdo moment se kush ka hyrë, koha si dhe kur ka futur të dhëna në program, orë sa ka punuar në program. Po ashtu është vërtetuar se ditën kur është verifikimi i dokumentacionit nga ana e komisionit në Njësinë e Dragashit, të akuzuarin nga ana e menaxhmentit është tentuar që të kontaktohet, por se i njëjti nuk është përgjigjur në telefon, dhe komisioni me atë rast kanë vazhduar punë e tyre, me verifikimin e dokumentacionit të prezentuara dhe kopjeve fizike të ditarve të cilët arakatari ligjërisht përpos formës elektronike të i mbajnë edhe ato, të cilat një kopje është në këtë Njësi, ndërsa kopja tjetër dorëzohet në Prizren në qendër, dhe të gjitha kopjet fizike ka qenë të nënshkruara nga arkatari – i akuzuari dhe personi përgjegjës i njësisë – menaxheri.

Nga draft raporti i auditimit të brendshëm mbi menaxhimin e arkës në Njësinë Punuese në Dragash e kryer nga zyra e auditimit të brendshëm të Hidroregjionit Jugor në Prizren me nr. 188 me datë 25.02.2016, gjykata ka vërtetuar se gjatë kontrollimit dhe ekzaminimit fizik të dokumentacionit të kësaj njësie të arkës nga ana e auditimit për periudhën kohore prej 01.10.2015 deri më 31.01.2016, është konstatuar se një shumë e konsiderueshme e mjeteve të inkasura dhe paguara në arkën e njësisë në Dragash, nuk janë regjistruar dhe nuk janë prezentuara në ditarin si të hyra ditore (Pazar ditore) dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk janë edhe deponuar, dhe shuma e tyre për katër muaj sillet rreth 2,500 euro. Në vazhdimi sipas këtij konstatimi, rrjedh se arkatari në mënyrë të rregullt palëve në fjalë iu ka lëshuar dëftesat për pagesa, si dhe të njëjtat nga ana e faturist janë shkarkuar në bazë të dhënave për konsumatorin, por se parat e pranuar nuk janë regjistruar në ditar të arkës, dhe të njëjtat edhe nuk janë deponuar.

Nga raporti i komisionit për regjistrimin dhe verifikimin e gjendjes në arkën e Njesisë Punuese në Dragash nga K.R.U Hidroregjioni Jugor në Prizren nr.243 të datës 07.03.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se ky komision i përbërë prej tre anëtarëve, ka bërë regjistrimin e gjendjes në këtë njësi me datë 29.02.2016, në të cilën ka konstatuar paregullësit prej muajit Tetor 2015 deri më 09.02.2016, dhe bazuar në ngarkimet dhe shkarkimet në këtë arkë, për periudhën kohore prej datës 19.10.2015 e deri më 09.02.2016, ka rezultuar se hyrje në arkë ka pasur në shumën prej 22,056.94€ ndërsa dalje/shkarkimë arkë ka pasur në shumën prej 18.750,65€, andaj në këtë rast është konstatuar një diferencë mangu në arkën e kësaj njësie në shumën prej 3.306.29€.

Nga regjistri me të dhënat të hyrjeve daljeve të arkës për periudhat gjatë muajit 02/2016 dhe 01/2016, gjykata ka vërtetuar se në mënyrë tabelare është vërtetuar të gjitha të hyrat dhe daljet e arkës së njesisë, për gjithë periudhën kritike, në të cilën rezulton se në arkë mungonë shuma prej 3306.84 euro.

Nga deklarata e të akuzuarit B. H. të dhënë në Hidroregjionin Jugor në Prizren me dorëshkrim, gjykata ka vërtetuar se nga përmbajtja e saj rezulton se i akuzuari në deklaratën e tij ka theksuar se lidhur me konstatimet e gjetura nga auditimi në ndërmarrjen e “Hidroregjionot” në njësinë e Dragashit, këto të gjetura i pranon si të tilla dhe në rastin konkret veten në këtë e konsideron fajtor. Nga ana tjetër, nga menaxhmenti i ndërmarrjes ka kërkuar, që shumën e cila është konstatuar të i mundësohet të kompensojë, përmes një kredie në bankë, si dhe sistemimin e tij në ndonjë pozitë tjetër të punës, apo edhe largimin nga puna.

Nga aktvendimi për iniciimin e procedurës disiplinore nga K.R.U Hidroregjioni Jugor në Prizren me nr.195 të datës 26.04.2016 kundër B. H., gjykata ka vërtetuar se e dëmtuara e lartpërmendur, ka filluar procedurën disiplinore ndaj të punësuarit – akuzuarit B. H., i sistemuar në punë si arkatar në Njesisë punuese në Dragash, për shkak të dyshimit të bazuar se një shumë e konsiderueshme e mjeteve të inkasuara në këtë njësi nuk janë regjistruar.

Nga vendimit mbi largimin-suspendimin e përkohshëm nga puna të akuzuarit B. H. të lëshuar nga K.R.U Hidroregjioni Jugor nr. 194 me datë 26.04.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari i sistemuar në punë arkatar pranë Njesisë punuese në Dragash, është suspenduar nga puna për shkak të mungesës së një shume të mejteve të inkasuara dhe paguara në arkën e kësaj njësie, të cilat nuk janë regjistrua në ditar si të hyra ditore, i cili suspendim do të zgjat gjer në përfundimin e procedurave disiplinore.

Nga raporti final mbi auditimin e arkës të Njesisë Punuese në Dragash me nr.189 të datës 25.02.2016, gjykata ka vërtetuar se auditori pas finalizimit të raportit të tij ka paraqitur auditimin e arkës për datën 01.10.2015 e deri 31.01.2016, dhe gjatë rishikimit të dokumentacionit të arkës – ditarëve si dhe krahasimit të atyre të dhënave me të dhënat financiare të gjeneruara nga sistemi i faturimit Navission dhe pas krahasimit të tyre me të dhënat – raportet financiare të përgatitura nga menaxhmenti i Njesisë, është konstatuar se se një shumë e konsiderueshme e mejteve të inkasura dhe paguara në arkën e Njesisë në Dragash, nuk janë regjistruar dhe nuk janë prezentuar në ditar si hyra ditor (Pazar ditor), dhe rrjedhisht si të tilla edhe nuk janë deponuar, dhe sipas të dhënave të cilat nuk janë definitive, në mungesë të dokumentacionit financiar, shuma për këtë peridhë katër mujor sillet rreth 2.500,00 euro. Dhe në fund nga ky raport poashtu është vërtetuar se arkatari, në mënyrë të rregullt palëve – konsumatorëve u ka lëshuar dëftesat për pagesë, si dhe të njëjtat nga ana e faturist janë shkarkuar nga baza e të dhënave të konsumatorëve, por se të hollat e pranuar nuk janë regjistruar në ditar të arkës, dhe të njëjtat nuk janë deponuar.

Nga njoftimin i ushtruesit të detyrës të Njesisë Punuese në Dragash me nr. 190 të datës 25.02.2016, gjykata ka vërtetuar se ushtruesi i detyrës së Njesisë, ka njoftuar Kryeshefin Ekzekutiv të KRU “Hidroregjioni Jugor” – Besim Baraliu, se bazuar në raportin e auditimit për periudhën kritike, e cili raport në mungesë të plot të dokumentacionit financiar, ka rekomanduar që të formohet një komision profesional, për verifikimin e dokumentacionit financiar, për konstatim përfundimtar të mungesës së mjeteve.

Nga vendimi për emërimin e komisionit për regjistrimin dhe verifikimin e gjendjes në arkën e njesisë punuese në Dragash nr. i prot. 196 të dt. 26.02.2016, gjykata ka vërtetuar se Kryeshefi Ekzekutiv pranë KRU “Hidroregjioni Jugor” në Prizren, ka marrë vendim për emërimin e komisionit lidhur me përcaktimin e dëmit për rastin e punonjësit – të akuzuarit B. H., i cili ka qenë në përbërje prej A. Z. – kryetar, I. F. anëtarë dhe Z. K. anëtarë.

Nga ekspertiza financiare e kryer nga eksperti I. K. i dt. 17.03.2017, gjykata ka vërtetuar se eksperti pas shikimit të dokumentacionit dhe vizitave të bërë në Njësinë e Dragashit të “Hidroregjionit Jugor” në Prizren, ka bërë analizimin e detajuar të hyrave dhe të dalurave të arkës në këtë Njësi, dhe ka dhënë mendimin në bazë të cilës i akuzuari për periudhën kohore 10/2015 e deri më 02/2016, nuk e ka bërë dorëzimin e të hollave në arkë (në emër të pazarit ditor – të pranuar nga inkasanti A. Z.), të cilat i ka mbajtur për vehte me qëllim të përfitimit material, dhe kështu buxheti i “Hidroregjionit Jugor” në Prizren, dega në Dragash, është dëmtuar në shumën prej 3.033,98 euro.

Lidhur me ekspertizën e kryer gjykata ka dëgjuar ekspertin edhe në shqyrtimit gjyqësor me datë 21.03.2017, i cili ka mbetur në tërësi pranë ekspertizës së dorëzuar me shkrim, ku ka treguar edhe metodologjinë e punës që ka përdorur në kryerjen e kësaj ekspertize, duke theksuar se raporti i inkasimit përfshin pazaret ditore të cilën inkasanti i ka bërë gjatë ditës, ndërsa libri i arkës i ka përfshirë të hyrat që i ka bërë gjatë ditës inkasanti, për shembull arka në Njësinë e Dragashit, deri më datën 18.10.2015, ka qenë çdo gjë në rregull, ndërsa mospërputhjet kanë filluar prej dt. 19.10.2015, ku konkretisht këtë datë, inkasanti kur i ka marrë pagesat prej palëve dhe i ka dorëzuar kontabilitetit me numër të arkës 168 i ka dorëzuar 174,60 euro, me nr. të arkës së kontabilitetit 169 edhe 285 euro, që do të thotë se totali është 459 euro, ndërsa në arkë të arkatari hyrje ka qenë 174 euro, e kjo tregon diferencën prej 280 euro, e që në realitet hyrje në arkë është dashur të jetë 459,60 euro, dhe kështu çdo ditë vazhdimisht janë paraqitur diferencat, për këto dëshmi janë raportet për dorëzimin e pazarit, ku shihet se inkasanti i ka dorëzuar ato ndërsa arkatari i ka marrë, duke potencuar se këto mjete brenda ditës arkatari ka pasur për obligim të i dorëzojë në bankë, ose më së voni të nesërmen. Më tutje ka shtuar se gjatë në shqyrtimit e dokumentacionit të Njesisë e Dragashit, menaxheri i kësaj njësie dhe një arkatar i kanë ofruar të gjithë dokumentacion në kopje dhe në ato dokumente kanë përfshirë të hyrat e inkasantit që i ka marrë prej konsumatorëve, të gjitha me emër dhe mbiemër dhe janë shkarkuar në kontabilitet aty ku është bërë pagesa dhe dorëzimi i pazarit ditor arkatarit. Eksperti ka sqaruar se gjatë ekspertimit ka vërejtur mospërputhje dhe atë prej datës 19.10.2015 në vazhdimësi, si rezultat i kësaj mospërputhje ndryshimi është 3.033.98 €.

Nga analizimi i ekspertit I. K., gjykata ka vërtetuar se gjendja në arkën e Njesisë në Dragash deri më datën 18.10.2015, ka qenë në rregull, ndërsa mospërputhjet në arkë kanë filluar nga data 19.10.2015 e tutje, ku në atë ditë nga totali i inkasimeve të dorëzuar arkatarit 459.60 euro, ndërsa në arkën e arkëtarit totali i hyrje për atë ditë ka qenë 174 euro, një diferencë prej 280 euro, ku këto diferencat janë paraqitur vazhdimisht dhe se ndryshimi i përgjithshëm është 3.033.98 €.

I akuzuari B. H., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ngel në tersi pranë deklaratës së dhënë në Prokurorinë e shtetit me datë 17.05.2016, duke theksuar se nga Qërshori i vitit 2015, ka filluar të

punon si arkatar në Njësinë Punuese “Hidroregjioni Jugor” në Dragash, dhe detyrat e tij si arkat kanë qenë arkëtimi i mjeteve, inkasimi i mjeteve, mbajtja e arkës së Njësisë punuese, dorëzimin e mjeteve nga faturisti, pranimin e –dorëzimin e materialit shpenzues –depoistit, edhe deponimin e mjeteve të pranuar në bankë në llogari të Hidroregjionit. Më tutje, ka theksuar, se pos tij inkasimin e këtyre mjeteve në këtë Njësi, kanë qenë edhe persona të tjerë inkasant J. Z., inkasant R. S., si dhe inkasimin e këtyrje mjeteve i ka bërë edhe financieri i NJH në Dragash H. R. Më tej ka theksuar se procedura e inkasimit të mjeteve dhe menaxhimi i tyre në këtë Njësi, ka qenë ashtu që palët të cilët janë drejtuar tek ai në zyre, i ka kryer me fletëpagesa të rregullta që posedon NHJ në Dragash, mjetet të cilat janë tubue konkretisht faturat i ka dorëzuar tek financieri, ndërsa financieri ka bërë raportin financiar të të gjithëve edhe inkasantëve të tjerë dhe me një raport përfundimtar i ka kthyer atij, dhe fillimisht këto mjete ai i ka deponuar në bankë dhe pastaj ka bërë raportin – ditarin e arkës. Më tej ka shtuar se ditari i arkës është nënshkruar nga ai dhe ushtruesi i detyrës së Njësisë, dhe kjo punë është bërë varësisht nga faturisti se si e ka kryer punën ai, duke shtuar se në vendin e tij të punës nuk ka pasur kompjuter personal, por ka punuar në kompjuterin e zyrës së menaxherit të Njësisë, në të cilin kompjuter ka pasur qasje edhe menaxheri, ai ka hapur kompjuterin dhe ai ka mbyllur kompjuterin. Thekson se si arkatar ka pasur autorizim që në llogari të Hidroregjionit të bën pagesat, ndërsa mjetet të cilat janë deponuar në këtë llogari ai nuk ka pasur autorizim që të i tërheq, ndërsa për diferencën në arkë është njoftuar nga ana e Prokurorisë. Më tej në deklaratën e tij ka theksuar se sakt nuk i kujtohet se kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës, por se fillimisht është suspenduar nga puna pastaj është ndërprerë marrëdhënia e punës, gjoja se ka bërë keqpërdorime, dhe gjatë auditimit që janë bërë në këtë Njësi, ai nuk ka qenë i ftuar, ndërsa prej momentit kur është suspenduar ai nuk ka bërë dorëzimin e dokumentacionit financiar në proces, dhe duke e mohuar fakin se ka përvetësuar shumën prej 3.306,00 euro sipas aktakuzës së Prokurorisë. Në vazhdim ka theksuar se ai ka qenë i ngarkuar me arkën e kësaj Njësie, ku ka bërë inksamin e hyrjeve dhe daljet – pagesat e ndryshme, duke shtuar se kompjuteri i zyrës ka qenë në zyrën e ushtruesit të menaxherit dhe ai ka pasur mundësi që të ketë qasje në arkë, por potencon se ai ka qenë përgjegjës për arkë. Ndërsa në pyetjen e Prokurorit të shtetit lidhur me deklarimin e tij në Prokurori në faqen 4 reshti i parafundit, në pyetjen se përveç tij a ka pasur qasje në arkë edhe ndonjë person tjetër, i akuzuari është përgjigjur se “jo sepse përveç meje në arkë tjetër nuk ka pasur mundësi të ketë qasje”, i akuzuari me këtë rast ka deklaruar se ai kompjuter personal nuk ka pasur, UD i menaxherit ka pasur qasje në kompjuter në të cilën ka qenë arka, dhe kjo është e vërteta, ndërsa atë që ka deklaruar në Prokurori, ka mundësi që se ka kuptuar pyetjen. Më tej i akuzuari ka shtuar se lidhur me gjendjen e gjetur nga Komisioni në arkën të cilën ka qenë i ngarkuar ka qenë i njoftuar dhe poashtu nga ana e zyrtarëve të Kompanisë, ka qenë i ftuar që të jep një deklaratë, por e mohon faktin se në deklaratë ka pranuar fajin për gjetjet të cilat janë konstatuara nga komisioni, deklarat e tij në atë rast ka qenë në lidhje me një problematikë tjetër, dhe se kjo deklaratë është bërë para inicimit të kësaj procedure, por se nuk i kujtohet para sa kohe. Në vazhdim i akuzuari ka theksuar lidhur me rastin konkret gjatë barazimeve të arkës dhe faturave, asnjëherë nuk ka vërejtuar ndonjë mospërputhje lidhur me rastin. Ndërsa, potencon se pas inkasimit të mjeteve nga konsumatorët, dëftesat – faturat janë dorëzuar faturistit në zyre, dhe kryesisht këtë procedurë e ka ndjekur edhe inkasantët e tjerë, pastaj faturist ka bërë një përmbledhje raporti, regjistrimi, janë shkarkuar nga borxhi që kanë pasur, pasi që ka qenë një sistem unik NJH në Prizren, dhe pastaj faturat, raporti i faturistit edhe mjetet janë dorëzuar të akuzuarit dhe ai ka bërë arkëtimin duke e regjistruar në ditarin e arkës, së bashku me të daluarat – pagesat që janë bërë, e cila punë është bërë në baza ditore. Dhe në fund i akuzuari në pyetjen e gjykatës se në deklaratën e dhënë në Prokurori ka pranuar se ka përvetësuar shumën prej 170 euro, dhe për këtë shumë e ka njoftuar shefin Q. T., me arsyetim se të njëtat do ti kthen për dy ditë, i akuzuari ka deklaruar se këto mjete nuk i ka përvetësuar, por të njëjtat i ka vonuar, duke mos i deponuar në bankë.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit të njëjtës pjesërisht ia fali besimin, dhe atë në pjesën të cilën i akuzuari ka pranuar se nga Qërshori i vitit 2015 deri në largimin e tij nga puna, ka

ka punuar si arkatar në Njësinë Punuese “Hidroregjioni Jugor” në Dragash, dhe detyrat e tij si arkat, ka qenë arkëtimi i mjeteve, inkasimi i mjeteve, mbajtja e arkës së Njësisë punuese, dorëzimin e mjeteve nga faturisti, pranimin e –dorëzimin e materialit shpenzues –depoistit, edhe deponimin e mejteve të pranuar në bankë në llogari të Hidroregjionit, si dhe procedurat lidhur me inkasimin e mjeteve nga ana e konsumatorëve në këtë Njësi, dhe se ditari i arkës është nënshkruar nga ai dhe menaxheri i Njësisë. Ndërkaq, sa i përket pjesës tjetër të mbrojtjes së akuzuarit së në vendin e tij të punës nuk ka pasur kompjuter personal, por se ka punuar në kompjuterin e menaxherit, i cili poashtu ka pasur qasje si në kompjuter dhe në arkë, dhe se pas barazimit të arkës dhe faturave asnjëherë nuk ka vëretjur ndonjë mosbarazim në arkë, dhe për diferencat për herë të parë është njoftuar në Prokurori, për gjykatën kjo deklaratë nuk ka qenë bindëse pasi që e njëjta është kontradiktore me deklaramet e tij të dhëna në prokurorin e shtetit, dhe se mbrojtja e tillë e të akuzuarit ka qenë në kundërshtim të plotë me deklaratata e dëshmitarëve Y. S., A. Z., nga ekspertiza financiare e eksperit I. K., si dhe nga provat materiale të administruara gjatë procedurës së provave. Andaj edhe mbrojtjen e tillë të akuzuarit gjykata e ka konsideruar vetëm si shmangie nga përgjegjësia penale pasi që nga provat e administruara dhe të vlerësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar një gjendje faktike krejtësisht tjetër nga ajo që pohon i akuzuari. Në realitet është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivet e këtij aktgjykimi se i akuzuari ka kryer veprën penale të lartëcekura për çka edhe është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv. Gjithashtu duke analizuar pjesën tjetër të mbrojtjes së akuzuarit, gjykata nuk ia fali besim, se nga të gjeturat e Komisionit lidhur arkën, në deklaratë e tij e ka mohuar se ka pranuar fajin lidhur me të gjetur e komisionit, se deklarat e tij ka qenë lidhur me një problematik tjetër, para inicimit të kësaj procedure, dhe se i njëjti e mohon faktin se ka pranuar se ka përvetësuar shumën prej 170 euro, dhe për këtë e ka njoftuar shefin Q. T., dhe se gjatë auditimit që janë bërë në këtë Njësi ai asnjëherë nuk ka qenë i ftuar nga ana e menaxhmentit, gjykata edhe në këtë drejtim mbrojtjes së këtillë nuk ia fali besimin, pasi një mbrojtje e tillë është mosbindëse dhe në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve të lartpërmendur si dhe provave materiale si dhe deklartës së tij të dhënë me dorëshkrim në Hidroregjionin Jugor, si dhe kontradikatat e deklaratë së tij me deklarëtn e dhënë në prokurorinë e shtetit, në të cilën ka pohuar se këto mjete i ka pranuar se i ka përvetësuar.

Nga te gjitha provat e administruara, nga dëgjimi i dëshmitarëve Y. S. dhe A. Z., në rastin konkret nuk është kontestuese dhe në tërësi është vërtetuar se i akuzuari B. H., ka qenë i punësuar në “Hidroregjionin Jugor” Njësinë punuese në Dragash në detyrën e tij të punës si arkatar, nga muaji Qërshor i vitit 2015 e deri në suspendimin e tij nga puna, respektivisht deri në largimin e tij nga puna në muajin Prill të vitit 2016. Sipas detyrave të punës në këtë kompani arkatari - akuzuari, ka qenë i obliguar që të bëjë regjistrimin në ditarin e arkës të gjitha hyrjet dhe daljet (pazarin ditor), ku përfshihen inkasimin ditor në bazë të urdhëresave që lëshohen për konsumatër, shpenzimet si dhe deponimet e mejteve të pranuar në llogari të Hidroregjionit në bankë. Deri në fund të muajit Shtator të vitit 2015 në arkën e kësaj Njësie në Dragash, nuk ishin vëretjur paregullësit në arkëtimin e të hyrave, mospërputhjet kishin filluar nga muaji Tetor, respektivisht nga 18 Tetori e tutje deri në mujin Shkurt të vitit 2016. Gjatë muajit Shkurt të vitit 2016 në Njësinë punuese të “Hidroregjionit Jugor” në Dragash, është bërë një auditim i brendshëm, dhe gjatë procesit të auditimit është konstatuar se një shumë e konsiderueshme e mjeteve të inkasuara dhe të paguara nga ana e konsumatërvës në arkën e Njësisë në Dragash nuk janë të prezantuara në ditarin e të hyrave si të hyra ditor, pra të njëjtat nga ana e të akuzuarit edhe pse ishin lëshuar dëftesë pagesat për konsumator, dhe këto nga ana e faturistit ishin shkarkuar nga gjendja e konsumatorit, por të hollat e grumbullura nuk janë regjistruara në arkë dhe rrjedhimisht të njëjtat edhe nuk ishin deponuar në llogarin e kompanisë në bankë, dhe shuma përafërt mungesës së të hollave sillej rreth 2500 euro. Pra, deri te ky konstatimi auditimi kishte ardhur pas kontrollimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, respektivisht ishte rishkuar dokumentacioni i arkës që ishte marrë nga shërbimi i kontabilitetit në Regjionin e Prizrenit si dhe është bërë krahasimi i këtyre të dhënave financiare nga sistemi elektronik i faturimit në

Prizren, dhe nga raportet financiare të Njesisë në Dragashit, dhe me këtë rast për vërtetimin saktë të gjendjes në arkë, menaxhmentit të kompanisë ishte rekomanduar që të formohet një komision profesional, si dhe është rekomanduar që ndaj arkatarit - akuzuarit të meren masa ligjore. Në këtë drejtim, komisioni prej tre anëtarëve, pas verifikimit të gjendjes në arkën e Njesisë në Dragash, për të cilën ka qenë përgjegjës i akuzuari ka konstatuar se ka pasur parregullsitë në këtë arkë, dhe nga peridha kohore prej muajit Tetor e deri më Shkurt të vitit 2016 është konstatuar diferenca në arkën e kësaj Njesisë në shumën prej 3.306,29 €. Në të vërtetë, komisioni deri tek ky konstatim ka ardhur pas verifikimit të dokumentacionit dhe harmonizimit të saj në sistemin e kontabilitetit, i cili është i përbashkët për të gjithë kompaninë, dhe pas harmonizimit të tyre është ardhur në përfundim se shuma financiare për peridhën e verifikimit, ka pasur një disproporcion dhe mosharmonizim i të dhënave financiare në shërbimin e kontabilitetit në bazën e konsumatëve me arkën e xhirollogarisë, pra nga mjetet të cilat janë grumbullura nga konsumatorët, i akuzuari nuk i ka regjistruara si hyrje në ditarin e arkës dhe njëherit këto mjete edhe nuk i ka deponuar në logarin bankare të kompanisë. Gjykata për vërtetimin e saktë dhe të paanshëm të faktit se a ka pasur keqpërdorim respektivisht përvetësim nga i akuzuari ka caktuar ekspertin e pavarur i cili ka kryer ekspertizën dhe sipas mendimit të ekspertizës ka vërtetuar se i akuzuari si arkatari Njesisë në Dragash, për përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore, nga pagesat të cilat janë realizuar nga inkasimit e konsumatorëve, një pjesë të tyre nuk i ka bërë dorëzimin e tyre në arkë, respektivisht në llogarin në bankë, por të njëjta çdo ditë në vazhdimësi i ka mbajtur për vehte, dhe kështu e ka dëmtuar buxhetin e “Hidro regjionit Jugor” në shumën prej 3.033,98 euro.

Gjykata, me këtë rast ka vërtetuar se i akuzuari si person zyrtar duke ushtruar pozitën e tij të arkatarit pranë Njesisë në Dragash pranë Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni”, dhe i njëjti duke mos i përmbajtur rregullave për regjistrimin e të hyrave në ditarin e arkës, mjetet të cilat ishin realizuar nga inkasimet e konsumatëve, i përvetëson për vehte duke mos i deponuar në llogarin bankare të kompanisë dhe kështu duke e dëmtuar kompaninë në shumën e përmendur si më lart. Dhe një fakt të tillë, e vërteton edhe nga pranimi i të akuzuarit në deklaratën e tij të dhënë me shkrim, ku i njëjti ka pohuar se këto mejte i ka përvetësuar për vehte, dhe të njëjtat do ti kompensojë përmes një kredi në bankë, të cilat fakte i akuzuari i kishte pohuar pjesërisht edhe në deklarin e tij të dhënë në prokurorin e shtetit.

Së këndejmi, nga te gjitha te cekurat si më larte gjykata gjeti se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPK dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe iu shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në neni 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, gjendjen e ekonomike, se është mbajtës i familjes, në gjykim ka pasur qëndrim korrekt. Andaj bazuar në këto rrethana gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPK-së dhe ky dënim i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Përveç kësaj, sa i përket dënimit plotësues mbi ndalim e ushtrimit të profesionit të arkatarit, ky vendim justifikohet nga fakti se vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të pozitës zyrtare, andaj edhe i shqiptoi një dënim të tillë.

Vendimi, mbi kompensimin e dëmit gjykata e mori konform nenit 458, dhe 463 të KPP-së, ku e obligojë të akuzuarin që shumat të cilat i ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme t'i kompensojë të dëmtuarës në shumën e përcaktuar si më lart.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.111/2016 më datë 22.03.2017

Procesmbajtësja
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.